



## Asistencë teknike për Institutin e Statistikave (INSTAT) dhe zyrat rajonale

### Konteksti i projektit

Konteksti i projektit është i lidhur me faktin që INSTAT-i ka hyrë në një fazë të rëndësishme të detyrave institucionale, me pasojë direkte mbi kredibilitetin dhe përafrimin e Sistemit Kombëtar të Statistikave të Shqipërisë me kushtet e BE. Organizimi i regjistrimit të planifikuar të popullsisë dhe pronave në 2011, regjistrimit të sipërmarrjeve bujqësore dhe atyre ekonomike jo bujqësore janë aktivitete të rëndësishme me impakte direkte jo vetëm mbi INSTAT por gjithashtu mbi zhvillimin e sistemit kombëtar të statistikave dhe mbi të gjithë vendin në përgjithësi. Për një vend, zbatimi i regjistrimit (census) mundëson prezantimin e një përshkrimi korrekt të këtij vendi para qeverisë dhe organizatave internacionale, të bazuar mbi një pasuri të dhënash cilësore si fakte për vendim marrje dhe për krahasime internacionale.

### Aktivitete Kryesore:

- Forcimin e rrjetit dhe zyrave rajonale të INSTAT-it: për mbështetjen e decentralizimit të disa aktiviteteve për statistikat, duke përmirësuar kapacitetet dhe aftësitë në zyrat rajonale të INSTAT-it dhe instalimin e një sistemi ICT që monitorohet nga Drejtoria e Përgjithshme e INSTAT-it dhe që përputhet me standartet europiane dhe praktikat më të mira nga vendet e tjera të BE.
- Përmirësimin e kapaciteteve të



- INSTAT-it për të kryer me sukses regjistrimet në vijim (bujqësisë dhe popullsisë): Ky synon mbështetjen e INSTAT-it për ngritjen e një strukture të përshtatshme dhe të plotë, planifikimin e aktiviteteve dhe zhvillimin e kompetencave dhe aftësive për përgatitjen e regjistrimit në bujqësi, të popullsisë dhe pronave në Shqipëri.
- De-koncentrimin e mbledhjes së të dhënave bazë statistikore dhe i përgjegjësi të anketimeve.

### Përfitimet

- Përfitimet nga zbatimi i projektit përfshijnë më së shumti zyrat rajonale, si dhe në shkallë vendi dhe për gjithë sistemin kombëtar të statistikave në lidhje me:
- Mundësimin e statistikave të sakta e koherente që e paraqesin vendin para qeverisë dhe organizatave nderkombetare, me kredibilitet dhe bazuar mbi një pasuri të dhënash statistikore, si fakte për vendimmarrje dhe për krahasime me vende të tjera.

- Rritjen e kapaciteteve të qëndrueshme në lidhje me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave dhe-veçanërisht-me analizën
- Aftësimin e INSTAT-it në prodhimin e vazhdueshëm dhe të besueshëm të dhënave rajonale mbi bazën e rregulloreve të NUTS dhe standarteve internacionale.

### FAKTET KRYESORE

#### PARTNERET:

- ✓ Komisioni Europian

#### KOHËZGJATIA:

Shtator 2009-Shtator 2010

#### PËRFITUESIT:

- ✓ INSTAT
- ✓ Zyrat rajonale

#### KONTAKT:

Zana Vokopola  
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14  
Hyrja 11, Ap. 56  
Tiranë  
Tel: +355 4 2256840  
E-mail: [uri@uri.org.al](mailto:uri@uri.org.al)  
Web: [www.uri.org.al](http://www.uri.org.al)

#### Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.